



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE ÇËSHTJEVE LIGJORE
Sektori i Koordinimit dhe Planifikimit Strategjik

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ .2020

Raporti 4-mujor i monitorimit të Programit të Statistikave Zyrtare¹ (Shtator-Dhjetor 2019)

¹ Ky raport hartohet në zbatim të Nenit 17, pika 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” Në mbështetje në nenit 17, pika 5 e Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT ka përgjegjësinë për t’i paraqitur Këshillit të Statistikave raporte të shkurtra 4-mujore për ecurinë e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare.

INSTAT - Instituti i Statistikave

Tel+(355) 4 2222411
+(355) 4 2233356
Fax+(355) 4 2228300

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H. 1, Nj.A. Nr.2, 1017,
Tiranë, Shqipëri

info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	3
Fusha statistikore 1: Statistikat demografike dhe sociale	4
Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike	6
Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale	9
Fusha statistikore 4: Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain	13



Hyrje

Programi i Statistikave Zyrtare është dokumenti bazë që parashikon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Kombëtar Statistikor të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë. Monitorimi i ecurisë së programit është element shumë i rëndësishëm për garantimin e plotësimin të aktiviteteve statistikore të parashikuara në të.

Ligji nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” parashikon si një ndër instrumentet monitoruese raportimin periodik me bazë 4-mujore.

Raporti 4- mujor mbi zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ) për periudhën Shtator – Dhjetor, 2019, është përgatitur në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore të cilat kanë dhënë informacion për modulet statistikore nën përgjegjësinë e tyre sipas programit. Ky raport i referohet Planit Vjetor 2019 për zbatimin e PSZ-së, i miratuar me vendim të veçantë të Kuvendit dhe përmban në strukturën e tij një informacion të shkurtër të ecurisë së aktiviteteve statistikore të planifikuara për secilën fushë. Ecuria e aktiviteteve statistikore monitorohet nëpërmjet raportimit të zbatimit të afateve të tre fazave kryesore të prodhimit statistikor: grumbullimi, përpunimi dhe publikimi i të dhënave. Për çdo fushë statistikore raportohen edhe aktivitetet statistikore për të cilat të dhënat nuk janë grumbulluar, përpunuar apo publikuar në kohë, shoqëruar me arsyen e moszbatimit të afateve. Pjesë e raportimit janë dhe aktivitetet statistikore nga të cilat nuk prodhohen të dhëna statistikore dhe aktivitetet e përealizuara gjatë periudhës së raportimit.

Raportet 4- mujore për ecurinë e Planit Vjetor për zbatimin e PSZ janë dokumentet bazë të cilat paraqiten nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT për Këshillin e Statistikave, dhe shërbejnë për hartimin e Raportit Vjetor i cili i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë.



PROGRES-RAPORTI Shtator-Dhjetor, 2019

Fusha statistikore 1: Statistikat demografike dhe sociale

Statistikat sociale përfshijnë një sërë fushash që lidhen me statistikën e popullsisë, tregut të punës dhe pagave, arsimit, shëndetësisë, të ardhurave dhe shpenzimeve të konsumit, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe krimit, kulturës, si dhe përdorimit të kohës.

- Objektivi kryesor i statistikave sociale është që të sigurojë të dhëna me cilësi të lartë dhe në kohë të treguesve statistikore të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave sociale dhe ekonomike me qëllimin final të zhvillimit dhe përmirësimit të mirëqënies shoqërore, si dhe në monitorimin e impaktit të këtyre politikave në aspektet e ndryshme të jetës në vend.

Agjencia statistikore përgjegjëse: INSTAT

Të dhënat janë grumbulluar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Statistikat vitale
- ✓ Anketa Tremujore e Forcave të Punës
- ✓ Statistikat e Tregut të Punës
- ✓ Të dhëna administrative mbi pagat
- ✓ Anketa e Buxhetit të Familjes
- ✓ Të dhëna administrative mbi mbrojtjen sociale
- ✓ ESSPROS
- ✓ Tregues për të dhënat e Kulturës

Të dhënat nuk janë grumbulluar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- Statistika të regjistrimeve në arsim - për arsimin parauniversitar

Arsyeja e mozbatimit të afatit: Mosardhja e të dhënave nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në afatin e kërkuar, për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti.

Të dhënat janë përpunuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Statistikat Vitale
- ✓ Anketa Tremujore e Forcave të Punës
- ✓ Statistikat e Tregut të Punës (për T2 2019)
- ✓ Anketa e Strukturës së të ardhurave nga Puna
- ✓ Të dhëna administrative mbi pagat
- ✓ Anketa e Buxhetit të Familjes



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës
- ✓ Të dhëna administrative mbi mbrojtjen sociale
- ✓ Tregues për të dhënat e Kulturës

Të dhënat nuk janë përpunuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- Statistika të regjistrimeve në arsim - për arsimin parauniversitar
Arsyeja e mozbatimit të afatit: Mosardhja e të dhënave nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në afatin e kërkuar, për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti i 26 Nëntorit.
- Anketa Tremujore e Forcave të Punës - për T3 2019
Arsyeja e mozbatimit të afatit: Pati vonesë në përpunimin e të dhënave për shkak të gjendjes së krijuar nga tërmeti i 26 Nëntorit.
- Statistikat e Tregut të Punës – Për T3 2019
Arsyeja e mozbatimit të afatit: Pati vonesë në përpunimin e të dhënave për shkak të gjendjes së krijuar nga tërmeti i 26 Nëntorit.

Të dhënat janë publikuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Statistikat Vitale
- ✓ Të dhëna administrative mbi pagat
- ✓ Të dhëna administrative mbi mbrojtjen sociale
- ✓ Tregues për të dhënat e Kulturës


Të dhënat nuk janë publikuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- Statistika të regjistrimeve në arsim - për arsimin parauniversitar
Arsyeja e mozbatimit të afatit: Mosardhja e të dhënave nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në afatin e kërkuar, për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti i 26 Nëntorit. Afati i publikimit ishte data 16 Dhjetor 2019.
- Anketa Tremujore e Forcave të Punës - për T3 2019
Arsyeja e mozbatimit të afatit: Për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti i 26 Nëntorit të dhënat u publikuan 1 javë me vonesë nga 11 Dhjetori kur ishte parashikuar publikimi në 18 Dhjetor 2019.
- Statistikat e Tregut të Punës – Për T3 2019
Arsyeja e mozbatimit të afatit: Për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti i 26 Nëntorit të dhënat u publikuan 2 ditë me vonesë nga 11 Dhjetori kur ishte parashikuar publikimi në 13 Dhjetor 2019.
- Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Arsyeja e mozbatimit të afatit: Për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti i 26 Nëntorit u vendos shtyrja e datës së publikimit nga 27 Nëntor në 16 Dhjetor.



1. Paraqitja grafike e realizimit të aktiviteteve sipas tre fazave të prodhimit statistikor për fushën statistikore 1: Statistikat Demografike dhe Sociale

Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike

Statistikat ekonomike përfshijnë fushat si: statistikat makroekonomike, statistikat financiare të qeverisë, fiskale dhe sektorit publik dhe statistikat e biznesit, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave ekonomike dhe përbëjnë bazën kryesore të informacionit për analiza të mëtejshme mbi zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së vendit.

- Qëllimi kryesor i statistikave ekonomike është që të sigurojnë të dhëna me cilësi të lartë dhe në kohë të treguesve statistikorë të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave ekonomike si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Të dhënat janë grumbulluar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Llogaritë Vjetore sipas sektorëve institucionalë
- ✓ Vlerësimi dhe publikimi i PBB tremujore me metodën e prodhimit me çmime korrente dhe konstante, vlerësime të papërshtatura dhe përshtatura sezonalisht



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Vlerësimi dhe publikimi i komponentëve kryesorë të PBB tremujore me metodën e shpenzimeve, e përshtatur dhe e papërshtatur sezonalisht
- ✓ Tabelat burime, përdorime dhe tabelat input-output
- ✓ Llogaritë financiare – Prodhimi i të dhënave
- ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera deponuese; Agregatët monetarë; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë
- ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasitë e reja dhe sasitë gjendje
- ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera financiare
- ✓ Statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar
- ✓ Vrojtimi tremujor për statistikën afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike
- ✓ Vrojtimi tremujor për statistikën e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike
- ✓ Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë

Të dhënat nuk janë grumbulluar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

Nuk ka.

Të dhënat janë përpunuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Vlerësimi dhe publikimi i PBB tremujore me metodën e prodhimit me çmime korrente dhe konstante, vlerësime të papërshtatura dhe përshtatura sezonalisht
- ✓ Vlerësimi dhe publikimi i komponentëve kryesorë të PBB tremujore me metodën e shpenzimeve, e përshtatur dhe e papërshtatur sezonalisht
- ✓ Tabelat burime, përdorime dhe tabelat input-output
- ✓ Llogaritë financiare – Prodhimi i të dhënave
- ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera deponuese; Agregatët monetarë; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë
- ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasitë e reja dhe sasitë gjendje
- ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera financiare
- ✓ Statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar
- ✓ Vrojtimi tremujor për statistikën afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike
- ✓ Vrojtimi tremujor për statistikën e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike
- ✓ Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë

Të dhënat nuk janë përpunuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- Ndërtimi i “Live Register” për përditësimin në kohë reale të regjistrimit statistikor të ndërmarrjeve

Arsyeja e mozbatimit të afatit: Përpunimi kërkon suportin e IT për vënien në funksion të datamodelit.

Të dhënat janë publikuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Vlerësimi dhe publikimi i PBB tremujore me metodën e prodhimit me çmime korrente dhe konstante, vlerësime të papërshtatura dhe përshtatura sezonalisht
- ✓ Vlerësimi dhe publikimi i komponentëve kryesorë të PBB tremujore me metodën e shpenzimeve, e përshtatur dhe e papërshtatur sezonalisht
- ✓ Tabelat burime, përdorime dhe tabelat input-output
- ✓ Llogaritë financiare – Prodhimi i të dhënave
- ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetarë; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë
- ✓ Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje
- ✓ Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera financiare
- ✓ Statistikat Financiare të Qeverisë sipas GFSM2014 dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë
- ✓ Statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar
- ✓ Vrojtimi tremujor për statistikafatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike
- ✓ Vrojtimi tremujor për statistikafatshkurtra të ndërmarrjet ekonomike
- ✓ Vlerësimi i statistikave strukturore në nivel rajonal për treguesit kryesorë
- ✓ Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë

Të dhënat nuk janë publikuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

Nuk ka.



2. Paraqitja grafike e realizimit të aktiviteteteve sipas tre fazave të prodhimit statistikor për fushën statistikore
2: Statistikat Ekonomike



Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale

Statistikat sektoriale përfshijnë një sërë fushash heterogjene si: statistikat e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve, statistikat e energjisë, transportit, turizmit, statistikat mbi tregtinë e jashtme dhe bilancin e pagesave, statistikat e çmimeve, shkencës dhe teknologjisë, inovacionit.

- Objektivi kryesor i statistikave sektoriale është që të sigurojnë të dhëna me cilësi të lartë dhe në kohë të treguesve statistikorë të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mbi fushat e sipërpërmendura si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e tyre.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT

Të dhënat janë grumbulluar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Vrojtim mbi sipërfaqen e mbjellë 2019
- ✓ Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta
- ✓ Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve
- ✓ Vrojtimi mujor në pularitë për prodhimin e vezëve
- ✓ Vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës
- ✓ Anketa mujore e çmimeve të prodhimeve bujqësore
- ✓ Anketa tremujore e çmimeve të inputeve në bujqësi dhe i kafshëve për mbarështim
- ✓ Bilanci i energjisë elektrike
- ✓ Bilanci i përgjithshëm i energjisë
- ✓ Prodhimi i treguesve statistikorë mbi transportin ajror, detar, ujqor i brendshëm dhe hekurudhor të mallrave dhe pasagjerëve
- ✓ Prodhimi i treguesve statistikorë mbi Aksidentet
- ✓ Prodhimi i treguesve statistikorë mbi lëvizjet (hyrje/daljet) e shtetasve të huaj dhe shqiptarë
- ✓ Anketa e Turizmit në Familje "Pushime dhe Udhëtime"
- ✓ Botimi "Bizneset e Huaja në Shqipëri"
- ✓ Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve
- ✓ Bilanci tremujor i pagesave
- ✓ Kryerja e vrojtimit dhe vlerësimit të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK)
- ✓ Vlerësimi i Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK)
- ✓ Matja e Fuqisë Blerëse (MFB)



Të dhënat nuk janë grumbulluar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

Nuk ka.

Të dhënat janë përpunuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Vrojtim mbi sipërfaqen e mbjellë 2019
- ✓ Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta
- ✓ Vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve
- ✓ Vrojtimi mujor në pularitë për prodhimin e vezëve
- ✓ Vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës
- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative për llogaritë ekonomike në bujqësi
- ✓ Anketa mujore e çmimeve të prodhimeve bujqësore
- ✓ Anketa tremujore e çmimeve të inputeve në bujqësi dhe i kafshëve për mbarështim
- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për prodhimin e statistikave mbi prodhimin e peshkut
- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative tremujore të peshkimit
- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative të agromjedisit
- ✓ Bilanci i energjisë elektrike
- ✓ Bilanci i përgjithshëm i energjisë
- ✓ Prodhimi i treguesve statistikorë mbi transportin ajror, detar, ujqor i brendshëm dhe hekurudhor të mallrave dhe pasagjerëve
- ✓ Prodhimi i treguesve statistikorë mbi Aksidentet
- ✓ Prodhimi i treguesve statistikorë mbi lëvizjet (hyrje/daljet) e shtetasve të huaj dhe shqiptarë
- ✓ Anketa e Turizmit në Familje "Pushime dhe Udhëtime"
- ✓ Botimi "Bizneset e Huaja në Shqipëri"
- ✓ Prodhimin e treguesve statistikorë mbi eksportet/importet e mallrave
- ✓ Prodhimi i treguesve statistikorë mbi eksportet/importet e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve
- ✓ Bilanci tremujor i pagesave
- ✓ Kryerja e vrojtimit dhe vlerësimit të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK)
- ✓ Vlerësimi i Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK)
- ✓ Matja e Fuqisë Blerëse (MFB)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Njësitë Ekonomike Familjare (NjEF)

Të dhënat nuk janë përpunuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

Nuk ka.

Të dhënat janë publikuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative për llogaritë ekonomike në bujqësi
- ✓ Anketa mujore e çmimeve të prodhimeve bujqësore
- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative për akuakulturën
- ✓ Bilanci i energjisë elektrike
- ✓ Bilanci i përgjithshëm i energjisë
- ✓ Prodhimi i treguesve statistikorë mbi transportin ajror, detar, ujor i brendshëm dhe hekurudhor të mallrave dhe pasagjerëve
- ✓ Prodhimi i treguesve statistikorë mbi Aksidentet
- ✓ Prodhimi i treguesve statistikorë mbi lëvizjet (hyrje/daljet) e shtetasve të huaj dhe shqiptarë
- ✓ Botimi "Turizmi në Shifra"
- ✓ Anketa e Turizmit në Familje "Pushime dhe Udhëtime"
- ✓ Botimi "Bizneset e Huaja në Shqipëri"
- ✓ Investimet direkte mjete dhe detyrime
- ✓ Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve
- ✓ Prodhimin e treguesve statistikorë mbi eksportet/importet e mallrave
- ✓ Bilanci tremujor i pagesave
- ✓ Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare
- ✓ Kryerja e vrojtimit dhe vlerësimit të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK)
- ✓ Vlerësimi i Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK)
- ✓ Matja e Fuqisë Blerëse (MFB)
- ✓ Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Njësitë Ekonomike Familjare (NjEF)

Të dhënat nuk janë publikuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

Nuk ka.

Për aktivitetet statistikore nga të cilët nuk prodhohen të dhëna statistikore janë arritur këto rezultate:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Zhvillimi i udhërrëfytyesve (guidelines) për sigurimin e konfidencialitetit statistikor si për të dhënat mikro edhe për ato tabelare:
Është përgatitur Politika e Konfidencialitetit dhe udhëzimet për zbatimin e saj.
- ✓ Dokumentimi i proceseve ekzistuese të sigurimit të konfidencialitetit statistikor
Janë dokumentuar të dhënat administrative për Përdorimin e Tokës, të dhënat administrative për Bujqësinë, të dhënat administrative për Blegtorinë, të dhënat administrative për Metodën e Prodhimit Bimor, Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore 2017, Llogaritë tremujore ekonomike në bujqësi, Llogaritë vjetore ekonomike në bujqësi, të dhënat administrative të Peshkimit, statistikën mbi Taksat Mjedisore, të dhënat administrative të Biodiversitetit, të dhënat administrative të Pyjeve dhe Kullotave, Vrojtimi i Sipërfaqes Mbjellë, Vrojtimi në Industrinë e Përpunimit të Drurit, Vrojtimi tremujor e çmimeve të kafshëve për mbarështrim, Vrojtimi Vjetor në Bujqësi 2018, Vrojtimi Vjetor në Bujqësi 2019, Vrojtimi Vjetor mbi Mbetjet e Ngurta Urbane në Shqipëri, Anketa e Produkteve Industriale – PRODCOM, Inovacioni 2019, Statistikat mbi Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2018, Anketa e Dhunës kundër Grave dhe Vajzave 2018, Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna, Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore 2018.
- ✓ Implementimi dhe standardizimi i metadatave strukturore në INSTAT:
Gjatë periudhës referuese janë përditësuar: Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës SILC, Anketa e Qumështit, Anketa e Buxhetit të Familjes, Rregjistri i ndërmarrjeve.
- ✓ Implementimi dhe standardizimi i metadatave referenciale në INSTAT.
- ✓ Trasferimi në Eurostat i metadatës në përputhje me standartin evropian për të gjitha fushat e prodhimit statistikor:
Janë transferuar nëpërmjet Sistemit Statistikor Evropian (ESS) Metadatat-Handler produktet si: Prodhimi Blegtoral, Anketa e Forcave të Punës, Të dhëna të detajuara mbi ngjarjet demografike, Statistikat vjetore të bimëve, Llogaritë ekonomike në mjedis.
- ✓ Publikimi në faqen e web-it të INSTAT i raporteve të metadatatave sipas fushave të prodhimit statistikor:
16 ESMS të plotësuar dhe publikuar: Statistikat e Krimeve, Lëvizjet e shtetasve, Statistikat e Transportit, Aksidentet rrugore, Statistikat e Arsimit, Statistikat e Shëndetësisë, Anketa e Buxhetit të Familjeve, Teknologjia e Informacionit dhe





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Komunikimit pranë Ndërmarrjeve, Statistikat e Bujqësisë, Statistikat e Blegtorisë, Vrojtimi Vjetor i Qumështit dhe nënprodukteve të tij, Anketa e Turizmit "Pushime dhe Udhëtime", Indeksi i Prodhimit në Industri, Indeksi i Prodhimit në Ndërtim, Indeksi i Shitjeve Neto në Industri, Indeksi i Shtjeve Neto në Shërbime.

- ✓ Harmonizimi i definicioneve statistikore me ato të EUROSTAT:
Publikimi i 16 raporteve të cilësisë sipas definicioneve të Eurostat.
- ✓ Pyetëtori i vetëvlerësimit për 4 aktivitete statistikore:
Është plotësuar pyetëtori i vetëvlerësimit për Anketën e Forcave të Punës.
- ✓ Auditi statistikor për 2 aktivitete statistikore
Janë hartuar draft-raportet për Auditin Statistikor për Anketën e Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve. Po punohet për Anketën e Buxhetit të Familjeve.
- ✓ Përmirësimi i rregullave të mbrojtjes së të dhënave dhe dokumentimi i plotë i procedurave:
Është rishikuar rregullorja e Politikës së Sigurisë së Informacionit si dhe është përgatitur në Shqip formati për Planin e Vazhdimësisë së Biznesit për Anketën e Buxhetit të Familjes.

Aktivitete të perealizuara:

Nuk ka.



3. Paraqitja grafike e realizimit të aktiviteteve sipas tre fazave të prodhimit statistikor si dhe i realizimit të aktiviteteve që nuk lidhen me prodhim të dhënash statistikore për fushën statistikore 3: Statistikat Sektoriale



Fusha statistikore 4: Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain

Statistikat e mjedisit dhe multidomain përfshijnë statistikat e mjedisit dhe statistikat rajonale dhe gjeohapësinore.

- Qëllimi kryesor i statistikave të Mjedisit dhe Multidomain është sigurimi i të dhënave me cilësi të lartë dhe në kohë i treguesve statistikorë të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mjedisore dhe socio-ekonomike, monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave si dhe integrimin e informacionit statistikor dhe atij gjeohapësinor me anë të të cilit synohet sigurimi i numrit më të madh të mundshëm të statistikave të gjeoreferuara në kohë dhe cilësi nga fusha të ndryshme të statistikave në një nivel territorial të detajuar.

Të dhënat janë grumbulluar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe agjencitë e tyre për prodhimin e statistikave mbi llogaritë rrjedhëse fizike në mjedis
- ✓ Prodhimi vjetor i statistikave mbi mbetjet, bazuar në të dhënat administrative
- ✓ Prodhimi vjetor i statistikave mbi mbetjet, bazuar në vrojtimin mbi mbetjet e ngurta urbane
- ✓ Prodhimi vjetor i statistikave të ujit, bazuar në të dhënat administrative
- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe agjencive të tyre në varësi për prodhimin e statistikave të zhurmave

Të dhënat nuk janë grumbulluar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe agjencive të tyre në varësi për prodhimin e statistikave të ajrit.

Arsyeja e moszbatimit të afatit: Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka grumbulluar të dhëna për këtë aktivitet referuar vitit 2018.

Të dhënat janë përpunuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe agjencitë e tyre për prodhimin e statistikave mbi llogaritë rrjedhëse fizike në mjedis
- ✓ Prodhimi vjetor i statistikave mbi mbetjet, bazuar në të dhënat administrative



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- ✓ Prodhimi vjetor i statistikave të ujit, bazuar në të dhënat administrative
- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe agjencive të tyre në varësi për prodhimin e statistikave të zhurmave

Të dhënat nuk janë përpunuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe agjencive të tyre në varësi për prodhimin e statistikave të ajrit.

Arsyeja e moszbatimit të afatit: Agjensia Kombëtare e Mjedisit nuk ka grumbulluar të dhëna për këtë aktivitet referuar vitit 2018.

Të dhënat janë publikuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Prodhimi vjetor i statistikave mbi mbetjet, bazuar në të dhënat administrative
- ✓ Prodhimi vjetor i statistikave mbi mbetjet, bazuar në vrojtimin mbi mbetjet e ngurta urbane
- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe agjencive të tyre në varësi për prodhimin e statistikave të zhurmave

Të dhënat nuk janë publikuar në kohë për aktivitetet si më poshtë:

- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe agjencive të tyre në varësi për prodhimin e statistikave të ajrit.

Arsyeja e moszbatimit të afatit: Agjensia Kombëtare e Mjedisit nuk ka grumbulluar të dhëna për këtë aktivitet referuar vitit 2018. Afati i publikimit të të dhënave ishte data 15 Nëntor 2019.


Për aktivitetet statistikore nga të cilët nuk prodhohen të dhëna statistikore janë arritur këto rezultate:

Inventarizimi i numrit të ndërtesave dhe karakteristikave të tyre

Gjatë këtij katërmujori ka vijuar puna për përditësimin e hartave të zonave të Censit. Ky aktivitet ka filluar në terren në muajin Prill 2019 dhe në muajin Dhjetor ka mbaruar mbledhja e të dhënave sipas planifikimit në Planin Vjetor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE



4. Paraqitja grafike e realizimit të aktiviteteve sipas tre fazave të prodhimit statistikor për fushën statistikore
4: Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain